



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 31

Prishtinë, më 3.3.2016, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Nenad Rashiq, Mexhide Mjaku-Topalli, Kujtim Paqaku dhe Etem Arifi.

Munguan: Valdete Bajrami, Teuta Haxhiu dhe Mytaher Haskuka.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës, Burim Tahiri mbështetës i Komisionit (UNICEF).

Pjesëmarrës të tjerë: Hilmi Jashari-Avokat i Popullit, Amire Qamili-Birn, Sahadete Zogaj-KosovaPress, Fjolla Uka-KDI, Mejreme Tahirukaj-Radio- Kosova, Fitore Ademi –RTV 21, Sanije Berisha-OSBE, Teuta Prekazi-Haxhibeqiri, OKB të Drejtat e Njeriut, Kaltrina Ahmeti-KDI, Osman Shatri-HANDIKOS, Visar Bivolaku-EVO/EUSR, Blerta Bejtullahu-EU/EUSR dhe Flora Kryeziu-UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 5.02.2016;**

3. **Diskutim lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit. (I ftuar Avokati i Popullit, z. Hilmi Jashari);**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit për të drejtat dhe statusin e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë;**
5. **Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 5.02.2016

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 5.2.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Diskutim lidhur me zbatimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit. (I ftuar Avokati i Popullit, z. Hilmi Jashari).

Kryetarja falënderoi Avokatin e Popullit për bashkëpunimin dhe prezencën në Komision. Ajo tha se në prezantimet Avokati i Popullit është deklaruar se ka një shkallë të rritjes së zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga ana e institucioneve, kjo është për t'u vlerësuar dhe për të gjitha këto do të prezantojë Avokati i Popullit.

Hilmi Jashari, Avokat i Popullit, fillimisht falënderoi komisionin për dhënien e mundësisë për t'i prezantuar para komisionit të arriturat e institucionit të Avokatit të Popullit për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2015, edhe pse raporti ende nuk është proceduar në Kuvend, kemi bërë analizën preliminare të gjitha rasteve të pranura dhe të gjitha rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015. Ai tha se mandatin e Avokatit të Popullit e ka marrë më 2 korrik 2015, dhe prej asaj periudhe zbatimi i rekomandimeve dhe zbatimi i tyre janë evidentuar në një tabelë të veçantë, dhe tani ju i keni përpara, është fakt se kemi pasur një ngritje të zbatimit të rekomandimeve. Ai njoftoi opinionin për rastin Grudiq, për kthimin e pensioneve nga Serbia. Ai, po ashtu, tha se kemi ngritje të raportimeve të rasteve nga institucionet për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe njoftoi për objektin e institucionit të Avokatit të Popullit dhe për mjetet financiare.

Kujtim Pacaku falënderoi Avokatin e Popullit që i ka sjellë rekomandimet në formë tabelore. Sa i përket lëndëve të pakicave pyeti sa a janë këto lëndë që janë realizuar apo çfarë tretmani kanë lëndët, sepse i intereson se a do të rritet efikasiteti për mbrojtjen e pronës, kthimi i pronave të uzurpuara që është një problem shumë i madh, e drejta për arsim të lartë, e drejta për banim, e drejta për përdorimin e gjuhës tradicionale, e drejta për punësim, dhe mbrojtja nga diskriminimi. Ai tha se përveç kthimit të fondit pensional nga Serbia, që u ngrit këtu, duhet të ngrihet edhe çështja e reparacionit, dhe se beson që të rritet efikasiteti i këtyre temave të cekura më lart,

problemet më të mëdha tha se po hasen në gjykata, ministri, komunë dhe polici. A thua vallë për këto të drejta duhet të bëjmë presion te komiteti i ministrave, të shkojmë si delegacion nga komisioni sepse ne po kemi presion nga qytetarët që të logojmë për këto tema dhe të hapet kapitull i ri për reparacionet e luftës që janë bërë në Kosovë.

Nenad Rashiq- Tha se është marrë me problematikën e pensioneve në tërësi dhe bëri pyetje se çfarë përgjigjeje po pritet nga këshilli i ministrave, vazhdimisht prej 2011 ka kërkuar nga Kryeministri që ta inkorporojmë në negociimin në Bruksel, por asgjë nuk ka ndodhur që 5 vjet, sepse numri i atyre që pretendojnë të përfitojnë nuk është 60 mijë, por shumë më pak, është me tendencë të zvogëlimit, dhe nëse nuk veprohet shpejt do të përfundojë pa përfitues.

Hilmi Jashari, Avokat i Popullit- Tha se sa i përket përfaqësimit të ankesave nga ana e minoriteteve, kemi edhe njerëz nga minoritete që punojnë në institucionin e Avokatit të Popullit dhe që janë në terren, kemi edhe zyrën që funksionon në veri të Mitrovicës, në zyrën në Graçanicë dhe kemi pjesëtarë të komunitetit ashkali që punojnë në kuadrin e zyrës së institucionit të Avokatit të Popullit dhe gjithmonë me tendencë që secili komunitet t'i ketë përfaqësuesit e vet dhe që t'i ngritin më së miri shqetësimet.

Tha se mbi bazën e ligjit të Avokatit të Popullit është paraparë që në zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të Popullit njëri të jetë nga ana e pakicës shumicë dhe një nga minoritetet e tjera jo shumicë që siguron një përfaqësim adekuat për ta plotësuar një standard ndërkombëtar të njohur. Sa i përket numrit të rasteve është në rritje ky numër nga ana e pakicave, e dini se zyra për qeverisje të mirë ka një mandat shumë të gjerë në mbrojtjen e pakicave në Kosovë dhe kanë ekzistuar disa strategji, ndër të tjera edhe ajo për të drejtat e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptias, duke përfshirë edhe kategori të tjera, kemi konsideruar se një dokument i vetëm që do të quhet strategjia për të drejtat e njeriut nga Qeveria e Kosovës, e cila do të kishte parasysht vetëm monitorimin në raport me të drejtat e njeriut do të ishte obliguese për të gjitha institucionet publike, e jo vetëm i një mekanizmi në kuadër të qeverisë.

Kemi rekomanduar që Kryeministri i Kosovës, së paku një herë në vit, të raportojë para Kuvendit lidhur me të arriturat apo dështimet që kanë pasur në fushën e të drejtave të njeriut, dhe deri tani ky rekomandim është përkrahur në parim. Në atë se sa janë pritjet si Avokat i Popullit, lidhur me komitetin e ministrave lidhur me rastin e pensioneve ai tha se nga viti 2012 deri në vitin 2016, kur kemi dërguar opinionin nuk ka pasur asnjë reagim zyrtar nga Qeveria e Kosovës në komitetin e ministrave, përderisa Serbia për çdo vit ka dërguar nga tri opinione me shkrim. Prandaj e kemi pa të nevojshme dhe jemi detyruar ta ndërmarrim këtë hap se kemi të bëjmë me interesin e përgjithshëm të qytetarëve dhe mendoj se kjo pikë nuk ka vend në bisedimet në Bruksel.

Nenad Rashiq-Tha se për shkak të neglizhencës ka kërkuar që të bisedohet çështja e pensioneve në Bruksel vetëm me arsyen që kjo çështje të shtyhet përpara.

Mexhide Mjaku-Topalli- Tha se kishte një pyetje lidhur me pensionet dhe për këtë mori përgjigje. Atij i interesoi të dijë se cili është roli i Avokatit të Popullit dhe çka mundeni të bëni ta ngrehni zërin për rastin e grave të dhunuara gjatë luftës, dhe te rekomandimi i 13, ku është fjala për ndryshimin dhe plotësimin e ligji për veteranët, dëshmorët, invalidët dhe pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për çka keni menduar cili nen duhet të ndryshohet?

Hilmi Jashari, Avokat i Popullit- Tha se te ligji për veteranët, dëshmorët, invalidët dhe pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kemi dërguar një raport sepse ligji realisht ka krijuar një farë kolizioni mes dispozitave për përfituesit, nëse keni mundur ta shihni komisioni ka pranuar mbi 160 000 kërkesa për përfitime nën këtë kriter për periudhat e ndryshme historike dhe në të cilat ne kemi konsideruar se në formën çfarë është një pritje legjitime, dhe si duket komisioni parlamentar është duke u marrë me atë rekomandim, kemi rekomanduar që në Kuvendin e Kosovës të bëhet një zyre e veçantë e cila do të merret me harmonizimin e legjislacionit, sepse deri më tani nuk ka një zyre të specializimeve, e cila kujdeset që të mos ketë shpërputhje mes dispozitave jo vetëm të drejtat e njeriut në ligj, por edhe ligjeve të ndryshme. Gjithashtu ai përmendi edhe ligjin për shpronësimin që ka shpërputhje.

Sa i përket rastit të grave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë ai tha se deri tani s' është asnjë ankesë në institucionin e Avokatit të Popullit që të kërkojë përkrahje. Nëse kjo kërkohet nga ndonjë organizatë që institucioni i Avokatit të Popullit të inkuadrohet ju siguroj se institucioni do të jetë i gatshëm të japë opinionet e veta.

Salihe Mustafa- Tha se është për t'u përshëndetur gjithë puna e institucionit, keni rekomanduar ndryshim dhe plotësim të neneve të ligjeve konkrete, shpeshherë nga institucionet ndodh të mos implementohen rekomandimet e dhëna nga ju në mungesë të ligjeve, besoj që kjo të merret shumë seriozisht nga ana e Kuvendit dhe komisioneve përkatëse, ndërsa ne, si komision, jemi të disponuar dhe do të kërkojmë nga institucionet përkatëse në implementimin e rekomandimeve të dhëna. Nga institucioni i Avokatit të Popullit, është për t'u përshëndetur opinioni i dërguar në komitetin e ministrave dhe besoj që kjo çështje nuk ka nevojë të shtrohet në bisedimet në Bruksel, por të zbatohet aktgjykimi i gjykatës. Sa i përket rekomandimit për zyrën administrative në veri të Mitrovicës për largimin më të shkurtër të parkut të paqes dhe në këtë rekomandim në afatin më të shkurtër nuk po shoh afat kohor, sa nënkupton ky afat i shkurtër dhe a keni bashkëpunim me këtë zyrë.

Hilmi Jashari,- Avokat i Popullit- Tha se ky rekomandim është i vitit 2015 dhe është bërë nga pararendësi i im, z. Kurteshi, që ka qenë Avokat i Popullit, mirëpo nuk ka pasur përgjigjeje lidhur me zbatimin e këtij rekomandimi. Ne kemi një nën zyre në veri të Mitrovicës dhe kemi dy përfaqësues në jug të Mitrovicës që të sigurohemi që të gjithë qytetarët e këtij rajoni të kenë qasje në institucionin e Avokatit të Popullit dhe kemi arritur një bashkëpunim me organizatat joqeveritare që merren me të drejtat e njeriut që të sigurohemi që të gjithë qytetarët të kenë qasje dhe Avokati i Popullit të jetë në gjendje t'i ngrehi këto shqetësime. Ai tha se e vetmja sfidë për momentin mbetet mbrojtja e qytetarëve në sektorin privat nga diskriminimi sepse është një fushë jashtëzakonisht e gjerë. Ai tregoi edhe për nxjerrjen e akteve nënligjore që janë të obliguar si institucion ta zbatojnë ligjin për Avokatin e Popullit.

Lirije Kajtazi – Pyeti se a është e nevojshme që Kushtetutës së Republikës së Kosovës t'i shtohet edhe ndonjë konventë tjetër ndërkombëtare, përveç atyre që janë të përcaktuara. Po ashtu ajo kërkoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me pakon ligjore për të drejtat e njeriut, e cila është miratuar disa muaj më parë. Gjithashtu ajo pyeti lidhur me çështjen e të drejtave të grave në trashëgimi. Këtë ajo e ndërlidhi me hartimin e Kodit Civil, i cili është në proces, mirëpo kërkoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me çështjen e trashëgimisë së grave. Ajo e përmendi edhe çështjen e monitorimit të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje duke e ndërlidhur me rolin e

Avokatit të Popullit lidhur me këtë çështje. Në fund kryetarja pyeti Avokatin e Popullit në bazë të kompetencës së tij për nisma legjislativë se a është e nevojshme të merret nismë për hartimin e një ligji i cili i precizon në mënyrë më të mirë sjelljet dhe veprimet e deputetëve duke i përfshirë edhe shprehjet e tyre.

Hilmi Jashari – Theksoi se për zyrat e barazisë gjinore kanë rekomanduar që ato ta kenë një lloj pavarësie, sepse këto zyra kanë funksionuar në kuadër të secilit institucion publik. Lidhur me këtë ai tha se problemi ka qenë te pavarësia e tyre për shkak se ato i janë përgjigjur nivelit hierarkik të këtyre institucioneve dhe nuk kanë pasur mundësi që funksionin e tyre ta ushtrjnë në mënyrë të pavarur, pikërisht për këtë shkak. Ai tha se rekomandimi i tyre ka qenë që këto zyra të lidhen drejtpërdrejt me zyrën për qeverisje të mirë dhe mos të jenë në vartësi të institucioneve të tjera, sepse për këtë shkak ato kanë pasur vështirësi në funksionimin e tyre. Lidhur me nevojën e inkorporimit të ndonjë konvente ndërkombëtare në kuadër të Kushtetutës së Kosovës, ai tha se Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore është pjesa ma qenësore e cila për momentin i konvenon më së shumti vendit tonë. Lidhur me këtë ai theksoi se ka shumë vështirësi lidhur me çështjet sociale dhe pikërisht për këtë do të ishte e mirëseardhur në këtë aspekt. Sipas tij ky dokument do të instalonte një standard sipas të cilit institucionin do të ishin të obliguara të plotësojnë nevojat sociale në Kosovë dhe kjo tregon më së miri rëndësinë e inkorporimit të kësaj konvente. Lidhur me trashëgiminë e grave në Kosovë kjo çështje është mjaft e komplikuar sepse në vete sjell edhe obligimet ndaj shtetit duke e precizuar pagesën e tatimeve dhe duke e ditur gjendjen aktuale të punësimit të grave do të jetë shumë e vështirë që të realizohet kjo dhe do të sjellë në vete komplikime të tjera. Ai në vazhdim theksoi se nëse tentohet me çdo kusht t'i lihet prona grave mund të ndodhë që të vije deri te bishtnimet e ndryshme të ligjit me qëllim që ajo pasuri sërish t'i lihet familjes sepse esenciale është deklarimi i sinqertë i grave se a dëshirojnë apo jo ta marrin trashëgiminë e familjes. Ai këto konstatime i bëri në bazë të diskutimeve me gratë të cilat në vazhdimësi kanë refuzuar ta marrin trashëgiminë.

Lidhur me çështjet e dhunës në familje se problem kyç është vonesa në shqiptimin e masave mbrojtëse, e sidomos urdhri për mbrojtje emergjente sepse në bazë të rregullit gjykata është e obliguar që ta lëshojë brenda 24 orëve urdhrin për mbrojtje emergjente dhe në këtë aspekt ka vonesa. Lidhur me rregullat e Kuvendit ai tha se e kanë një opinion i cili do të publikohet e që ka të bëjë me gjuhën fyese, nxitëse dhe ofenduese në mediat publike. Ai theksoi se ka hapësirë që të plotësohet Rregullorja e Kuvendit sepse këtë më së miri e kanë treguar ngjarjet e fundit dhe pikërisht për këtë është e nevojshme që të bëhen ndryshime që i parashohin veprimet e tilla në vazhdim.

Kujtim Paqaku – Pyeti Avokatin e Popullit lidhur me refuzimin e kërkesave të kosovarëve me nevoja sociale për realizimin e ndihmës sociale për fëmijët që i mbushin 5 vjet. Lidhur me këtë ai theksoi se në këtë mënyrë atyre personave u vështirësohet mënyra e jetesës, sepse mundësinë materiale e pamundësojnë këtë. Ai ishte i mendimit që të bëhet ndryshimi i ligjit dhe të ndryshohet edhe ky përcaktim ligjor në bazë të cilës e humbin të drejtën për skemat sociale. Ai pyeti rreth mënyrës dhe bazës juridike të hartimit të strategjisë për të drejtat e njeriut, sepse sipas mendimit të tij strategjia e ka bazën në Kushtetutë, respektivisht në ligje.

Hilmi Jashari – Lidhur me pyetjen e parë të parashtruar nga parafolësi theksoi se qysh në vitin 2008 kanë rekomanduar që të ndryshohet ky kriter në Ligjin për skemat e ndihmës sociale, mirëpo nuk është marrë parasysh asnjëherë dhe që nga ajo kohë ka mbetur i pandryshuar. Ai theksoi se kjo është tejet diskriminuese dhe duhet të ndryshohet. Ai kishte vërejtje edhe te rastet e ndihmës sociale te personat me aftësi të kufizuara, përkatësisht te përcaktimi ligjor sipas të cilin një person me aftësi të kufizuar në mënyrë që të jetë përfitues ndihmën sociale duhet të ketë paaftësi të përhershme dhe në këtë mënyrë eliminohen personat që nuk e kanë paaftësinë e përhershme. Lidhur me strategjinë ai theksoi se kanë bërë një rekomandim në bazë të cilit të hiqen përshkrimet narrative dhe të cekën qartazi objektivat, afatet kohore dhe aktivitetet që duhet të kryhen në kuadër të strategjisë.

Kujtim Paqaku- Ishte i mendimit që këto raporte të cilat u cekën nga Avokati i Popullit t'i dërgohen institucioneve të Kosovës, por edhe Këshillit të Evropës.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë

Kryetarja – Theksoi se Grupi i Punës ka punuar në këtë drejtim dhe tani është koha ku do të caktohet data e mbajtjes së dëgjimit publik në të cilin do të paraqiten të arriturat e deritashme të punës, si dhe do të merren parasysh propozimet e tjera nga grupet e interesit që do të jenë pjesëmarrës në këtë dëgjim. Lidhur me datën e mbajtjes së Dëgjimit Publik ajo tha se data 16 mars do të jetë më e përshtatshme për të mbajtur dëgjimin.

Nenad Rashiq - Lidhur me këtë theksoi se Projektligji nuk është përfundimtar dhe vetëm kur të jetë i kompletuar do të procedohet tutje. Ai theksoi se do të ketë ndikime shtesë disa përcaktime që janë dakorduar si Komision t'i ndërmarrin, andaj si përfundim ai tha se të gjitha propozimet janë inkorporuar dhe ishte i mendimit që të takohen me Komisionin për Buxhet dhe të diskutojnë lidhur me ndryshimin e kostos financiare. Ai tha se kanë tentuar që t'i përfshijnë sa më shumë nevojat e kësaj kategorie që nëpërmes këtij ligji t'i mundësohet atyre plotësimi i nevojave të tyre dhe në këtë mënyrë ligji të jetë sa më mirë i zbatueshëm e jo vetëm pjesërisht. Ai theksoi se kanë propozuar ngritjen e të ardhurave për 10 euro për këtë kategori të personave. Pajisjet që ju nevojiten personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë të cilat janë të domosdoshme për nevojat e tyre. Lidhur me këtë ai theksoi se mbikëqyrja e ligjit nuk do të mbikëqyrët vetëm nga ana e komunave, por edhe nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Lidhur me rehabilitimin e këtyre personave ai theksoi se institucionet në Kosovë e kanë të vështirë ta mbulojnë këtë dhe kjo është mjaft sfiduese, sepse Komisioni është përpjekur që t'i përfshijë sa më mirë edhe këto çështje me ligj. Ai përmendi refuzimin me pajisje sepse pajisjet amortizohen me kohën dhe lidhur me këtë ai theksoi se e kanë paraparë që çdo 5 vjet të bëhet rifurnizimi i këtyre personave me pajisje. Ai në fund theksoi se janë të gatshëm të diskutojnë në Dëgjim Publik lidhur me këtë projektligj. Ky është draft dhe pret që të ketë harmonizim me Komisionet e tjera, në mënyrë që ligji të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe sa më mirë i hartuar në mënyrë që të ketë zbatim efektiv.

Lirije Kajtazi – Tha se 16 marsi të jetë datë e mbajtjes së Dëgjimit Publik. Lidhur me këtë Dëgjim Publik ajo kërkoi që të ftohen personat kompetentë në mënyrë që Dëgjimi Publik të jetë sa më mirë i organizuar, duke e precizuar edhe bashkëpunimin me Komisionin për Shëndetësi dhe pjesëmarrjen e tyre në Dëgjim Publik.

Mbledhja përfundoi në orën 15:30.
E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit

Lirije Kajtazi